

## Marrëveshje për mbrojtjen e të dhënave personale

Në mënyrë që të llogariten *Benefits* sipas *Benefit program*, myWorld Kosovo Shpk, Rr. "Tirana Lakrishte" HB4, 40, Prishtinë, Kosovë) mbledh dhe përpunon të dhënat personale të Anëtarit, veçanërisht emrin dhe mbiemrin e tij, titullin, gjininë, datën e lindjes, adresën e postës elektronike/email, adresën postare, koordinatat e adresës (gjerësia dhe gjatësia), numri/at i/e telefonit , numri/at i/e faksit, ID i Anëtarit, detajet e llogarisë bankare (banka, IBAN, SWIFT dhe mbajtësi i llogarisë) si dhe informacionin rreth zakoneve të shit-blerjeve dhe blerjes së Anëtarëve (data, vendndodhja dhe koha e blerjes, shuma e blerjes, valuta, informacioni i shportës së blerjes, sektori, lloji i blerjes (*online, offline*), mesazhet; Ilogaria kyç, me *myWorld Card*). Kur përpunohen të dhënat e sipërpërmendura, myWorld Kosovo Shpk, Rr. "Tirana Lakrishte" HB4, 40, Prishtinë, Kosovë mund të përdorë gjithashtu si përpunues të të dhënave myWorld 360 AG (Grazbachgasse 87-93, 8010 Graz, Austri).

Anëtari nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij – nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që myWorld Kosovo Shpk, Rr. "Tirana Lakrishte" HB4, 40, Prishtinë, Kosovë mund të përpunojë detajet e të dhënave të tij personale të përmendura më sipër për qëllimin e kontaktimit me të përmes postës ose personalisht nga myWorld Kosovo Shpk, Rr. "Tirana Lakrishte" HB4, 40, Prishtinë, Kosovë me telefon ose me anë të dërgimit automatik të njoftimit (*push notification*) për t'i bërë reklamë *Benefit Program-it* ose ofertave të myWorld dhe Kompanisë Partnere.

Anëtari gjithashtu nëpërmjet këtij akti jep pëlqimin e tij - nga i cili mund të heqë dorë në çdo kohë - që informacioni i mëposhtëm mund t'i ofrohet Rekomanduesit të Anëtarit me qëllim krijimin e kontaktit në lidhje me Kompanitë e reja Partnere, mundësitë e reja të blerjes ose ofertat speciale: ID-ja e Anëtarit, emri dhe mbiemri, adresa e email dhe numri i telefonit.

Anëtari mund të tërheqë pëlqimin(et) e tij (edhe veçmas) me shkrim nga myWorld Kosovo Shpk, Rr. "Tirana Lakrishte" HB4, 40, Prishtinë, Kosovë ose me email nëpërmjet [service.xk@myworld.com](mailto:service.xk@myworld.com) në çdo kohë me efekt të ardhshëm. Pëlqimi i dhënë në këtë akt për përpunimin e të dhënave personale është i vlefshëm deri kur Anëtari ka të hequr këtë pëlqim. Nëpërmjet këtyre të dhënave të kontaktit, Anëtari gjithashtu mund të ushtrojë të drejtën e tij për të kërkuar informacion, kryer ndryshime, , fshirje, kufizime në lidhje me përpunimin e të dhënave dhe transferimin e tyre.